



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1286/prot.  
3

Tiranë më 8.11.2017

VENDIM

Nr. 96, datë 8.11.2017

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/I të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Shoqata "Intelektualët e Rinj, Shpresë" (IRSH) përfaqësuar nga Z.

, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") formularin e ankesës nr. 1286 Prot., datë 25.09.2017, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi nëpërmjet kërkesave së datave 28.08.2017, 29.08.2017, 30.08.2017, 31.08.2017 dhe 04.09.2017, 05.09.2017, 06.09.2017 ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion dhe dokumentacionin si më poshtë:

- a) *Kërkesa nr. 1 datë 28 Gusht 2017: Kopje të urdhrit nr. 1477 datë 24.02.2015 i Ministrisë së Drejtësisë "Për miratimin e strukturës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (sipas detyrimit të përcaktuar për autoritetet publike në nenin 7, pika 1, germa a të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit")*,
- b) *Kërkesa nr. 2 datë 29 Gusht 2017: Kopje të Rregullores së brendshme të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kopje të Urdhrit të Kryetarit të Gjykatës nr. 3 datë 07.01.2015 për ndarjen e gjyqtarëve në seksione dhe çështjeve me short elektronik (sipas detyrimit të përcaktuar për autoritetet publike në nenin 7, pika 1, germa b të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit")*,
- c) *Kërkesa nr. 3 datë 30 Gusht 2017: Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit*

- përkatës (sipas detyrimit të përcaktuar për autoritetet publike në nenin 7 pika 1, gërma c të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit").*
- d) *Kërkesa nr. 4 datë 31 Gusht 2017: Kopje të urdhrët nr. 53, datë 29.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në lidhje me emrin dhe kontaktin e koordinatorit për të drejtën e informimit (sipas detyrimit të përcaktuar për autoritetet publike në nenin 7, pika 1, gërma ç të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit").*
- e) *Kërkesa nr. 5 datë 04 Shtator 2017: Të dhëna për arsimin dhe kualifikimet e funksionarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pagat e funksionarëve të cilët kanë detyrimin për deklarim të pasurisë sipas ligjit dhe strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, procedurat e zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të këtij autoriteti publik, procedurat për marrjen e vendimeve (sipas detyrimit të përcaktuar për autoritetet publike në nenin 7, pika 1, gërma d të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit").*
- f) *Kërkesa nr. 6 datë 05 Shtator 2017: Raporte të Auditimit të KLSH ose subjekteve të tjera, dokumente në lidhje me performancën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (sipas detyrimit të përcaktuar për autoritetet publike në nenin 7, pika 1 gërma dh të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit").*
- g) *Kërkesa nr. 7 datë 05 Shtator 2017: Të dhëna mbi buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin 2017, raport vjetor për zbatimin e buxhetit të viteve paraardhës (sipas detyrimit të përcaktuar për autoritetet publike në nenin 7, pika 1, gërma e të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit).*  
*Kërkesa nr. 8 datë 06 Shtator 2017: Informacion lidhur me antarët e Komisionit për blerje të vogla në institucionin Tuaj (sipas detyrimit të përcaktuar për autoritetet publike në nenin 7, pika 1, gërma ë të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit).*
- h) *Kërkesa nr .9 datë 06 Shtator 2017: Informacion lidhur me shërbimet që ofron Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke përfshirë standartet dhe cilësinë e shërbimit (sipas detyrimit të përcaktuar për autoritetet publike në nenin 7 pika 1 gërma f të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit").*

Autoriteti Publik nuk i është përgjigjur kërkuarit. Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuar ka paraqitur ankimin nr. 1286 Prot., datë 25.09.2017 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr. 1286/1 Prot, datë 04.10.2017, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni.

Autoriteti Publik është përgjigjur me tonën nr. 1286/2 Prot., datë 18.10.2017, duke sqaruar me arsyetimin se: *Të dhënat e kërkuara për kërkesën nr.1 datë 28 Gusht 2017, kërkesën nr.2 datë 29 Gusht 2017, kërkesën nr.3 datë 30 Gusht 2017, kërkesën nr.4 datë 31 Gusht 2017, kërkesën nr.6 datë 5 Shtator 2017, kërkesën nr.7 datë 5 Shtator 2017 dhe kërkesën nr.9 datë 6 shtator 2017 gjenden në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër: [Gjykata.gov.al-gjykatat/shqiptare-gjykatat-e-rretheve-gjykata-e-rrethit-shkodër](http://Gjykata.gov.al-gjykatat/shqiptare-gjykatat-e-rretheve-gjykata-e-rrethit-shkodër). Në lidhje me kërkesën nr.5 datë 4 Shtator 2017 dhe kërkesën nr.8 datë 6 Shtator*

*2017 Autoriteti Publik vë në dispozicion vetëm referencën ligjore pa dokumentacionin përkatës shoqërues.*

Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke refuzuar dhënien e informacionit në tejkalim të çdo afati të përcaktuar në ligjin për të drejtën e informimit.

Komisioneri pas konsultimit të legjislacionit përkatës vlerëson se, informacioni i kërkuar nga shoqata “Intelektualët e Rinj, Shpresë” (IRSH), përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*” dhe si i tillë, dhënia e tij nuk mund të refuzohet.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit të sipërcituar: “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

Krahas faktit që informacioni publik duhet të publikohet në mjediset e autoritetit publik, apo kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet, nga monitorimi i faqes zyrtare është konstatuar se informacioni nuk rezultoi i publikuar si parashikohet në ligj dhe nuk është i aksesueshëm.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Për sa më lart, në lidhje me ankimin e shoqatës “Intelektualët e Rinj, Shpresë” (IRSH), përfaqësuar nga Z. \_\_\_\_\_ ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i bazuar në ligj dhe si i tillë ai duhet pranuar.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’,

## **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankimit të shoqatës “Intelektualët e rinj, Shpresë” (IRSH) përfaqësuar nga Z. \_\_\_\_\_, nr. 1286 Prot., datë 25.09.2017, kundër Autoritetit Publik “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar:

- a) Kopje të urdhrimit nr. 1477 datë 24.02.2015 i Ministrisë të Drejtësisë "Për miratimin e strukturës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
  - b) Kopje të Rregullores së brendshme të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kopje të Urdhrit të Kryetarit të Gjykatës nr. 3 datë 07.01.2015 për ndarjen e gjyqtarëve në seksione dhe çështjeve me short elektronik;
  - c) Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
  - d) Kopje të urdhrimit nr. 53, datë 29.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në lidhje me emrin dhe kontaktin e koordinatorit për të drejtën e Informimit
  - e) Të dhëna për arsimin dhe kualifikimet e funksionarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pagat e funksionarëve të cilët kanë detyrimin për deklarim të pasurisë sipas ligjit dhe strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, procedurat e zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të këtij autoriteti publik, procedurat për marrjen e vendimeve
  - f) Raporte të Auditimit të KLSH ose subjekteve të tjera, dokumente në lidhje me performancën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër
  - g) Të dhëna mbi buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin 2017, raport vjetor për zbatimin e buxhetit të viteve paraardhës
  - h) Informacion lidhur me shërbimet që ofron Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke përfshirë standartet dhe cilësinë e shërbimit, brenda datës 16 . 11 .2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u dha sot në datë 08 . 11 .2017.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

